

Mundësi për Bashkitë për aplikim në Thirrjen e 6-të për Projekte të Vogla nën programin Interreg VI-A IPA III CBC Greqi–Shqipëri 2021–2027

Kodi i thirrjes: 6th GR-AL 2.7

Thirrja synon financimin e projekteve të vogla me karakter ndërkufitar ndërmjet Greqisë dhe Shqipërisë, me fokus kryesor mbrojtjen e natyrës, biodiversitetit, infrastrukturës së gjelbër dhe reduktimin e ndotjes.

1. Synimi i thirrjes:

Qëllimi i thirrjes është forcimi i mbrojtjes së natyrës dhe biodiversitetit, zhvillimi i infrastrukturës së gjelbër, përfshirë zonat urbane, reduktimi i formave të ndryshme të ndotjes dhe forcimi i kapaciteteve të institucioneve që merren me menaxhimin dhe mbrojtjen mjedisore në zonat ndërkufitare.

Thirrja mbështet projekte që krijojnë rezultate konkrete dhe të qëndrueshme në të dyja anët e kufirit dhe që bazohen në bashkëpunimin ndërmjet institucioneve greke dhe shqiptare. Programi thekson veçanërisht rëndësinë e përfshirjes së njësive më të vogla vendore, organizatave lokale mjedisore, shoqatave dhe komuniteteve rinore. Një element i rëndësishëm është të tregohet që bashkëpunimi ndërkufitar nuk është thjesht formal por jep rezultate konkrete. Projektet duhet të kontribuojnë në kuptimin e përbashkët të problematikave mjedisore dhe në zhvillimin e zgjidhjeve të koordinuara dhe afatgjata ndërmjet dy vendeve. Thirrja inkurajon gjithashtu projekte që përfshijnë të rinjtë në aktivitete konkrete të komunitetit, duke zhvilluar aftësi, pjesëmarrje qytetare dhe përgjegjshmëri ndaj mjedisit.

2. Kush mund të aplikojë:

Subjektet e pranueshme për të aplikuar janë:

Organet publike rajonale (qarqet) ose vendore (bashkitë).

Organizatat jofitimprurëse, me kusht që të mos jenë krijuar për qëllim fitimi, të mos shpërndajnë fitime tek aksionarët dhe të kenë të paktën një vit të plotë aktiviteti financiar përpara hapjes së thirrjes.

Grupimet Evropiane të Bashkëpunimit Territorial (EGTC), në përputhje me kushtet e përcaktuara në thirrje.

Për bashkitë, kushti kryesor është që territori i tyre të jetë brenda zonës së pranueshme të Programit.

Kërkesa të rëndësishme për partneritetin

Një projekt nuk mund të paraqitet nga një bashki e vetme.

Partneriteti duhet të përfshijë **minimumi 2 përfitues, një nga Shqipëria dhe një nga Greqia**, ndërsa numri maksimal është **4 përfitues**. Partnerët duhet të bashkëpunojnë në zhvillimin dhe zbatimin e projektit, si dhe në financimin dhe/ose stafin e projektit.

Një institucion mund të marrë pjesë **vetëm në një projekt** në kuadër të kësaj thirrjeje. Ky kufizim zbatohet në nivel institucioni dhe jo në nivel drejtorie apo njësie organizative. Nëse një përfitues paraqitet në më shumë se një projekt, vetëm propozimi i parë i dorëzuar në MIS do të vlerësohet.

3. Cilat janë fushat dhe tipet e aktiviteteve:

Thirrja ka **një objektiv specifik: RSO2.7 – Nature protection and biodiversity.**

Projektet duhet të lidhen me **një**rën nga dy kategoritë e ndërhyrjes:

077 – Masa për përmirësimin e cilësisë së ajrit dhe reduktimin e zhurmës.

079 – Mbrojtja e natyrës dhe biodiversitetit, trashëgimisë dhe burimeve natyrore, si dhe infrastruktura e gjelbër dhe blu.

Nëse një projekt përfshin të dyja fushat, duhet të përzgjidhet ajo kategori ndërhyrjeje që ka **buxhetin më të madh.**

Aktivitetet e pranueshme përfshijnë, ndër të tjera:

- Ndërhyrje të vogla për ruajtjen e natyrës dhe biodiversitetit, veçanërisht ndërhyrje të gjelbra në zonat urbane, si **rrugica ose korridore me pemë, trotuare të gjelbra dhe ndërhyrje të ngjashme.**
- Aktivitete ndërgjegjësimi për reduktimin e ndotjes, përfshirë **fushata ndërgjegjësimi, aktivitete të përbashkëta dhe shkëmbime.**
- Zhvillimin e kapaciteteve të autoriteteve mjedisore dhe OJQ-ve për **menaxhimin e përbashkët të zonave natyrore dhe ekosistemeve ndërkufitare.**
- Masa dhe veprime pilot për **parandalimin dhe trajtimin e ndotjes në mjedisin natyror ndërkufitar** dhe mbrojtjen e biodiversitetit dhe kapitalit natyror të përbashkët.
- Masa për **përmirësimin e cilësisë së ajrit në zonat urbane**, kontrollin dhe monitorimin e ndotjes së ajrit, përfshirë zhvillimin e zgjidhjeve për monitorimin e cilësisë së ajrit.
- Promovimin e praktikave dhe zgjidhjeve për parandalimin e aktiviteteve që dëmtojnë biodiversitetin, si **shpyllëzimi, mbifertilizimi dhe mbipeshkimi.**

Thirrja inkurajon gjithashtu aktivitete kapitalizimi, pra përdorimin ose transferimin e rezultateve, produkteve apo praktikave të suksesshme të projekteve të mëparshme të financuara nga Interreg Greqi–Shqipëri 2014–2020 ose programe të tjera të BE-së. Këto rezultate mund të përshtaten për zona të reja, grupe të reja përfituese ose partnerë të rinj.

Për një bashki, kjo do të thotë se projektet më të përshtatshme janë ato që kombinojnë **një problem konkret lokal me një zgjidhje të përbashkët ndërkufitare**, për shembull infrastrukturë të gjelbër, monitorim të ajrit, mbrojtje të biodiversitetit, reduktim të ndotjes ose menaxhim të përbashkët të burimeve natyrore.

4. Cilat janë zonat përfituese:

Për Shqipërinë, zonat e pranueshme janë këto **5 qarqe/njësi rajonale**:

Berat – AL031

Fier – AL032

Gjirokastër – AL033

Korçë – AL034

Vlorë – AL035.

Kjo do të thotë se, nga **61 bashkitë e Shqipërisë**, vetëm bashkitë që ndodhen brenda këtyre pesë **qarqeve** mund të jenë përfituese në këtë thirrje.

Për Greqinë, zona e Programit përfshin rajone/njësi si Kefallinia, Lefkada, Thesprotia, Grevena, Kastoria, Kozani, Florina, Ioannina, Arta, Preveza, Kerkyra dhe Zakynthos.

Në parim, aktivitetet e projektit duhet të zhvillohen **brenda zonës së Programit**. Përfshirje mund të lejohen për shpenzime udhëtimi dhe akomodimi jashtë zonës, vetëm kur ato janë të justifikuara, në interes të zonës së Programit, thelbësore për projektin dhe të miratuara sipas rregullave të Programit.

5. Cili është buxheti i thirrjes dhe buxheti për projekt:

Buxheti i përgjithshëm i thirrjes është **1,000,000 EUR**, i financuar nga fondet e BE-së dhe fondet kombëtare.

Norma e kontributit të BE-së është **80%**. Përfituesit duhet të sigurojnë kontributin e tyre, publik dhe/ose privat sipas rastit.

Për një projekt individual:

Buxheti minimal: 120,000 EUR

Buxheti maksimal: 400,000 EUR.

Për çdo partner, buxheti maksimal është **200,000 EUR** dhe nuk ka një minimum të përcaktuar për buxhetin e partnerit.

Kjo ka një rëndësi praktike: një projekt maksimal prej 400,000 EUR mund të ketë, për shembull, një partner shqiptar me deri në 200,000 EUR dhe një partner grek me deri në 200,000 EUR. Partneriteti mund të ketë deri në katër përfitues, por kufiri prej 200,000 EUR zbatohet për secilin partner.

Projektet duhet të përfundojnë brenda një periudhe maksimale prej **18 muajsh nga nënshkrimi i kontratës së grantit**.

6. Cilat janë kostot e pranueshme:

Thirrja parashikon dy mënyra financimi dhe **çdo partner duhet të zgjedhë një prej tyre**. Partnerët e të njëjtit projekt mund të përdorin opsione të ndryshme. Zgjedhja e metodës nuk mund të ndryshohet gjatë zbatimit ose pas përfundimit të projektit.

Opsioni 1: Kostot e stafit si kosto reale.

Kostot direkte të stafit llogariten mbi bazën e kostove reale bruto të punësimit. Të gjitha kategoritë e tjera të kostove mbulohen me një normë fikse deri në **40% të kostove direkte të pranueshme të stafit**. Kjo përfshin administrimin dhe zyrën, udhëtimet dhe akomodimin, pajisjet, ekspertizën/shërbimet e jashtme, si dhe infrastrukturën dhe punimet.

Në këtë opsion, gjatë raportimit kërkohen prova për kostot reale bruto të stafit, si dokumentet e punësimit, listëpagesat, vendimet e emërimit dhe timesheet-et.

Opsioni 2: Kostot direkte si kosto reale.

Kostot reale përfshijnë **pajisjet, ekspertizën dhe shërbimet e jashtme, si dhe infrastrukturën dhe punimet.**

Kostot e stafit llogariten me normë fikse deri në **20% të kostove direkte**, ndërsa administrimi/zyra dhe udhëtimet/akomodimi llogariten me normë fikse deri në **15% të kostove të pranueshme direkte të stafit**, sipas strukturës së përcaktuar në thirrje.

Në praktikë, për bashkitë që kanë ndërhyrje fizike, pajisje ose punime infrastrukturore, **Opsioni 2 duhet analizuar me kujdes**, ndërsa për projekte që mbështeten më shumë në burime njerëzore dhe aktivitete soft, Opsioni 1 mund të jetë më i përshtatshëm. Megjithatë, zgjedhja duhet të bëhet mbi bazën e buxhetit dhe aktiviteteve konkrete të projektit.

Shpenzimet duhet të respektojnë rregullat e pranueshmërisë të përcaktuara në Guidance on Small-Scale Projects dhe Programme and Project Implementation Manual. Data përfundimtare e pranueshmërisë së kostove është **31 dhjetor 2029** dhe projekti duhet të jetë përfunduar fizikisht dhe financiarisht deri në këtë datë.

7. Si bëhet aplikimi?

Aplikimi bëhet **vetëm në mënyrë elektronike në sistemin MIS** të Programit.

Platforma e aplikimit është: <https://logon.ops.gr/>

Aplikimi duhet të dorëzohet nga **Përfituesi Kryesor (Lead Beneficiary)**, në emër të të gjithë partneritetit. Formulari i aplikimit plotësohet ekskluzivisht në formatin elektronik në MIS. Përfituesit duhet të plotësojnë formularin dhe të ngarkojnë të gjitha dokumentet e detyrueshme brenda afatit. Për një bashki shqiptare, procesi praktik duhet të nisë me identifikimin e një **partneri të përshtatshëm grek** dhe përcaktimin e rolit të secilit partner në projekt. Dokumentet kryesore që duhet të shoqërojnë aplikimin përfshijnë **Partnership Declaration**, formularin e justifikimit të buxhetit dhe dokumentet e tjera të kërkuara sipas kategorisë së përfituesit. Dokumentet e detyrueshme duhet të jenë të nënshkruara dhe të ngarkohen elektronikisht në MIS. Mungesa e dokumenteve të detyrueshme mund të çojë në skualifikim. Përveç tyre, duhet të dorëzohen dokumentet që provojnë kapacitetin administrativ dhe financiar të përfituesit, kompetencën ligjore për zbatimin e aktiviteteve, si dhe, kur është e aplikueshme, dokumentet që lidhen me funksionimin dhe mirëmbajtjen e investimit. Për projektet që përfshijnë punime infrastrukturore të vogla, dokumente si studimet, lejet, projektet teknike, preventivat, dokumentet e pronësisë dhe miratimet përkatëse mund të paraqiten si dokumentacion mbështetës. Ato nuk janë domosdoshmërisht të detyrueshme për aplikim sipas këtij seksioni, por cilësia dhe disponueshmëria e tyre mund të ndikojnë pozitivisht në vlerësimin e projektit. Përfituesit duhet të kenë llogaritë përkatëse të përdoruesve në MIS. Vlerësimi zhvillohet në disa faza: kontrolli administrativ dhe i pranueshmërisë, vlerësimi i cilësisë, vlerësimi i pranueshmërisë së përfituesve dhe përputhshmërisë me rregullat për ndihmën shtetërore dhe rezistencën klimatike, si dhe optimizimi dhe finalizimi i buxhetit.

8. Kur është afati i fundit:

Afati përfundimtar për dorëzimin e projektpropozimeve është: **30 shtator 2026, ora 15:00 (Ora e Greqisë).**

9. Linku i thirrjes:

<https://greece-albania.eu/call/6th-open-call-for-small-scale-project-proposals-under-s-o-2-7>